

# **LIGJI I SHOQERIVE (RISHIKIMI I 2003)**

## **SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **AKTI I THEMELIMIT**

#### **I**

#### **SAXON INTERNATIONAL ENERGY LTD.**

1. Emri i Shoqerise eshte **SAXON INTERNATIONAL ENERGY LTD.**
2. Zyra e Regjistruar e Shoqerise ndodhet ne zyrat e **Walkers SPV Limited, Walker House, Mary Street, PO Box 908GT, George Town, Grand Cayman, Cayman Islands** ose ne cfaredo vendi qe mund te percaktohet nga Drejtoret here pas here.
3. Qellimet per te cilat eshte krijuar Shoqeria jane te pakufizuara dhe Shoqeria do te kete fuqi dhe autoritet te plote per te realizuar cdo qellim te pandaluar me ligj sic eshte parashikuar nga pika 7(4) e Ligjit te Shoqerive (i rishikuar ne vitin 2003).
4. Shoqeria do te kete dhe do te jete e afte te ushtroje e gjitha funksionet e nje personi natyral me kapacitet te plote pavaresisht nga ceshtja e perfitimit te perbashket te parashikuar nga Pika 27(2) e Ligjit te Shoqerive (i rishikuar ne vitin 2003).
5. Asgje nga pikat e meparshme nuk do te mendohet se e lejon Shoqerine te kryeje biznesin e nje Banke apo Shoqerie Trusti pa qene e licencuar per kete sipas dispozitave te Ligjit te Bankave dhe Shoqerive te Trusteve ( i rishikuar ne vitin 2003), ose te kryeje Biznes Sigurimesh nga Ishujt Cayman ose biznesin e nje Menaxheri Sigurimesh, Agjenti, Nen-Agjenti ose Komisioneri pa qene te lincsuar per kete sipas Ligjit te Sigurimeve ( i rishikuar ne vitin 2003), ose te kryeje biznesin e Menaxhimit te Shoqerive ( i rishikuar ne vitin 2003).
6. Shoqeria nuk do te tregtoje ne Ishujt Cayman me person, firme ose korporate pervec se ne mbeshtetje te biznesit te Shoqerise jashte Ishujve Cayman; me kusht qe asgje ne kete pike do te interpretohet sikur ndalon kryerjen dhe konkludimin e kontratave ne Ishujt Cayman, dhe ushtrimin ne Ishujt Cayman e te gjitha fuqive te saj per vazhdimin e biznesit jashte Ishujve Cayman.
7. Pergjegjësia e anetareve eshte e kufizuar me shumen, nese ekziston, te papaguar per aksionet qe mbahen respektivisht nga ta.
8. Kapitali i autorizuar i aksioneve te Shoqerise eshte 2,000,000.000 dollare amerikane e ndare ne 100,000,000 aksione te zakonshme te nje vlere nominale

prej 0,01 dollaresh secila dhe 100,000,000 aksione te paemeruara te nje vlere nominale prej 0,01 dollaresh secila, gjithmone me kusht qe nenshtruar Ligjit te Shoqerive ( varianti i rishikuar ne 2003) dhe Statutit te Shoqerise, Shoqeria do te kete fuqine te ribleje ose bleje cdonje nga aksionet e saj dhe t'i nendaje ose konsolidoje aksionet ne fjale ose cdonje nga ato dhe te jape te gjitha ose pjese te kapitalit te vet, nese origjinal, te riblere, te rritur ose te reduktuar me ose pa ndonje preference, prioritet ose privilegj te vecante ose subjekt te ndonje shtyrje te drejtave ose te cfaredo kushti ose kufizimi dhe ne menyre te tille qe, vetem nese kushtet e dhenies parashikojne shprehimisht se nuk eshte keshtu, cdo dhenie e aksioneve, te deklaruar te Zakonshme ose Preferenciale , do te jete subjekt i fuqive te Shoqerise te parashtruara me lart.

9. Shoqeria mund te ushtroje fuqite e parashtruara ne Piken 226 te Ligjit te Shoqerive (i rishikuar ne 2003) per t'u cregjistruar ne Ishujt Cayman dhe te regjistrohesh me ane te vazhdimesise ne ndonje juridiksion tjetet.

I nenshkruari, emri, adresa dhe pershkrimi i te cilit eshte nenshkruar, deshiron te formohet si Shoqeri ne ndjekje te ketij Akti Themelimi, dhe eshte dakort te marre numrin e aksioneve ne kapitalin e Shoqerise, vendosur perballe emrit te tij.

---

**EMRI, ADRESA DHE PERSHKRIMI  
I NENSHKRUESIT**

**NUMRI I AKSIONEVE TE  
MARRA NGA NENSHKRUESI**

---

**Philip Paschalides**  
PO Box 265GT  
Grand Cayman

NJE AKSION

(Sgd.) **Philip Paschalides**

---

**Philip Paschalides**  
Attorney-at-Law

15 Shkurt 2004

(Sgd.) **Sarah Sullivan**

---

Deshmitare e nenshkrimet te mesiperm: **Sarah Sullivan**

Adresa: PO Box 265GT, Grand Cayman

Profesioni: Sekretare

Une, D. EVADNE EBANKS, Asistent ne Regjistrin e Shoqerive, ne dhe per Ishujt Cayman, **VERTETOJ KETU** se kjo eshte nje kopje e vertete e Aktit te Themelimit te **SAXON INTERNATIONAL ENERGY LTD.**

Data: 15 Prill 2004.

(firma, vula)

# **LIGJI I SHOQERIVE (I RISHIKUAR NE 2003)**

## **KOMPANI E KUFIZUAR NGA AKSIONET**

### **STATUTI**

#### **I**

### **SAXON INTERNATIONAL ENERGY LTD.**

#### **TABELA A**

Rregulloret e permbajtura ose te inkorporuara ne Tabelen "A" ne Skedulen e Pare te Ligjit te Shoqerive (i Rishikuar ne 2003) nuk do te zbatohen tek kjo Shoqeri dhe Nenet ne vijim do te perbejne Statutin e Shoqerise:

#### **INTERPRETIMI**

1. Ne keto Nene:

**"Ligji i Shoqerive"** do te thote Ligji i Shoqerive ( i rishikuar ne 2003) ne Ishujt Cayman;

**"Drejtoret"** dhe **"Keshilli Drejtues"** do te thote Drejtoret e Shoqerive per kohen ne fjale, ose sipas rastit, Drejtoret e mbledhur si Keshill ose komitet;

**"Anetar"** do te thote nje person emri i te cilit ka hyre ne Regjistrin e Anetareve dhe perfshin cdo te nenshkruar ne Aktin e Themelimit te Shoqerise, te ndryshuar apo rishpallur here pas here;

**"Rezolute e Zakonshme"** do te thote nje rezolute:

- (a) e kaluar me shumice votash te thjeshte te Anetarave te tille qe jane te titulluar per te bere nje gje te tille, te votojne vete, ose kur perfaqesite jane te lejuara, me ane te perfaqesise ne nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise dhe kur behet votimi, do te konsiderohet llogaritja e shumices se numrit te votave qe cdo Anetar eshte i titulluar; ose
- (b) e miratuar me shkrim nga te gjithe Anetaret qe jane te titulluar te votojne ne nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise, ne nje ose me shume instrumente, secili i

firmosur nga nje ose me shume Anetare dhe data kur rezoluta adoptohet do te jete data ne te cilen instrumenti, ose i fundit i instrumenteve nese me shume se nje, ekzekutohet;

**“e paguar”** do te thote e e paguar sipas vleres nominale dhe cdo premiumi te pagueshem ne lidhje me dhenien e aksioneve dhe perfshin kreditimet e paguara;

**“Anetare te Regjistruar”** do te thote regjistri qe mbahet nga Shoqeria ne perputhje me Piken 40 te Ligjit te Shoqerive;

**“Vula”** do te thote Vula e Perbashket e Shoqerise ( nese e adoptuar) perfshire cdo riprodhim te saj;

**“aksion”** do te thote cdo aksion ne kapitalin e Shoqerise, perfshire edhe nje fraksion te ndonje aksioni;

**“e firmosur”** perfshin nje firme ose perfaqesimin e nje firme te fiksuar me mjete mekanike;

**“Rezolute Speciale”** do te thote rezolute e kaluar ne perputhje me Piken 60 te Ligjit te Shoqerive, rezolute:

(a) e kaluar me shumice votash jo me pak se dy te tretat te atyre Anetareve te titulluar per ta bere nje gje te tille qe votojne vete, ose kur lejohet perfaqesia, me ane te perfaqesise ne mbledhje te pergjithshme te Shoqerise kur eshte dhene pershtatshmerisht njoftimi qe specifikon qellimin per te propozuar rezoluten si Rezolute Speciale dhe do te konsiderohet llogaritja e shumices se numrit te votave qe cdo Anetar eshte i titulluar; ose

(b) e miratuar me shkrim nga te gjitha Anetaret qe jane te titulluar te votojne ne nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise, ne nje ose me shume instrumente, secili i firmosur nga nje ose me shume Anetare dhe data kur Rezoluta Speciale adoptohet do te jete data ne te cilen instrumenti, ose i fundit i instrumenteve nese me shume se nje, ekzekutohet.

2. Ne keto Nene, pervecse kur konteksti e kerkon ndryshe:

(a) fjalet qe mbartin numrin njejes do te perfshijne edhe numrin shumes dhe e anasjellas;

(b) fjalet qe mbartin vetem gjinine mashkullore do te perfshijne edhe gjinine femerore;

(c) fjalet qe mbartin vetem persona do te perfshijne shoqeri ose shoqata ose organizata personash, qofte korporata ose jo;

- (d) **“mund”** do te interpretohet si lejuese dhe **“do te”** do te interpretohet si urdheruese;
  - (e) referimet te **“dollarit”** ose **“dollareve”** ose \$ eshte referim i dollareve amerikane; dhe
  - (f) referimet e miratimit statutor do te perfshijne referimet e cdo ndryshimi ose rimiratimi te ketyre nga koha e ardhjes ne fuqi.
3. Ne varesi te dy Neneve te fundit pararendese, cdo fjale e perkufizuar ne Ligjin e Shoqerive do te, nese ne konflikt me subjektin ose kontekstin, mbarte te njejtin kuptim ne keto Nene.

### **PRELIMINARE**

- 4. Biznesi i Shoqerise mund te filloje aq shpejt pas regjistrimit si ta gjejne te pershtatshme Drejtoret.
- 5. Zyra e regjistruar e Shoqerise do te jete ne ate adrese ne Ishujt Cayman sikurse Drejtoret do te vendosin here pas here.

### **AKSIONET**

- 6. Ne varesi te cka mund te parashikohet ndryshe ne keto Nene, te gjitha aksionet qe per momentin dhe here pas here te cautorizuara do te jene nen kontrollin e Drejtoreve mund te ricaktohen, shpermdahen ose shiten ne menyre te tille, dhe personave te tille dhe nen terma te tille qe Drejtoret brenda diskrecionit te tyre te plote, e konsiderojne te pershtatshme.
- 7. Shoqeria mundet, per sa kohe lejohet nga ligji, t'i paguaje komision cdo personi kur konsideron nenshkrimin e tij ose kur bie dakort per ta nenshkruar, plotesisht ose me kusht per cdonje nga aksionet. Keto komisione mund te shlyen me ane te pagimeve cash ose me depozitim e aksioneve plotesisht ose pjeserisht te paguara, ose pjeserisht ne nje menyre dhe pjeserisht ne nje tjeter. Shoqeria, mundet gjithashtu, ne cdo autorizim aksionesh te paguaje komisionerin per sa kohe qe eshte i ligjshem.

### **NDRYSHIM I TE DREJTAVE TE BASHKANGJITURA AKSIONEVE**

- 8. Nese, ne cfaredo kohe, kapitali i aksioneve eshte i ndare ne klasa te ndryshme aksionesh, te drejtat e bashkangjitura cfaredo klase ( vec nese jane te parashikuara ndryshe nga termat e autorizimit te aksioneve te asaj klase) mund te ndryshohen ose shfuqizohen me pelqimin me shkrim te aksionereve te dy te tretave te

aksioneve te autorizuar te asaj klase, ose me sanksionin e nje rezolute te kaluar me te pakten dy te tretat e aksionereve te aksioneve te klases prezente ose me ane te perfaqesise ne nje mbledhje te pergjithshme te vecante e aksionereve te aksioneve te asaj klase. Ne cdo mbledhje te pergjithshme te vecante, dispozitat e ketyre Neneve do te zbatohen mutatis mutandis, por ne menyre te tille qe kuorumi i nevojshem te jete te pakten nje person qe mban ose perfaqeson te pakten nje te treten e aksioneve te autorizuar te klases dhe qe cdo aksioner i aksioneve te klases prezente ne person ose me ane te perfaqesise mund te kerkoje votim.

9. Te drejtat e akorduara aksionereve te aksioneve te cdo klase qe i jane dhene te drejta preferenciale ose te tjera te drejta , nuk do te, vec nese eshte parashikuar ndryshe shprehimisht nga termat e autorizimit te aksioneve te asaj klase, te ndryshohen ose shfuqizohen nga krijimi i aksioneve te metejshtme te njejtirang ose nga riblerja apo blerja prej Shoqerise e aksioneve te cfaredo klase .

### **CERTIFIKATAT**

10. Cdo person emri i te cilit ka hyre is anetar ne Regjistrin e Anetareve, eshte i titulluar, pa pagese, per nje certificate ne formen e percaktuar nga Drejtoret. Kjo certificate mund te jete e Vulosur. Te gjitha certifikatat do te specifikojne aksionin ose aksionet e mbajtura nga ai person dhe pagesa e bere per to, me kusht qe ne lidhje me nje aksion ose aksione te mbajtura bashkarisht nga disa persona, Shoqeria nuk do te detyrohet te autorizojte me shume se nje certificate, dhe dhenia e nje certificate per nje aksion nje ose disa aksionereve te perbashket do te jete e mjaftueshme per te gjitha.
11. Nese nje certificate aksionesh eshte e demtuar, ka humbur, ose eshte shkaterruar, mund te rinovohet mbi terma te tille ne perputhje me evidencen dhe zhdemtimin, qe Drejtoret mendojne si te pershtatshme.

### **AKSIONET FRAKSIONALE**

12. Drejtoret mund te autorizojne fraksione te nje aksioni te cfaredo klase aksionesh, dhe, nese e autorizuar, nje fraksion i nje aksioni ( i llogaritur deri ne tre numra dhjetore) do te jene subjekt i, dhe mbartin fraksionin korrespondues te pergjegjesive ( nese ne lidhje me sasite e papaguara per te, kontribuet, kerkesat, ose te tjera), kufizimeve, preferencave, privilegjeve, kualifikimeve, te drejtave (perfshire, pa kufizime, te drejtat e votes dhe pjesemarrjes) dhe attributeve te tjera te nje aksioni te plote te te njejtës klase aksionesh.

### **BARRA**

13. Shoqeria do te kete nje barre te perparesise kryesore dhe do te ngarkoje mbi cdo aksion te paguar pjeserisht , per te gjitha parate ( nese momentalisht te pagueshme ose jo) e kerkuara oe te pagueshme ne nje kohe te fiksuar ne lidhje me ate aksion, dhe Shoqeria do te kete gjithashtu nje barre te perparesise kryesore mbi te gjitha

aksionet pjeserisht te paguara te regjistruara ne emrin e nje Anetari ( nese te mbajtura vetem ose se bashku me nje person tjeter) per te gjitha parate momentalisht te pagueshme prej tij ose prona e tij, Shoqerise, por Drejtoret munden qe ne cdo kohe te deklarojne cfaredo aksioni teresisht ose pjeserisht te perjashtuar nga dispozitat e ketij Neni. Barra e Shoqerise mbi nje aksion do t'i zbatohet edhe te gjithë distribuimeve te pagueshme prej kesaj.

14. Shoqeria mund te shese ne menyre te tille qe Drejtoret ne diskrecionin e tyre te plote konsiderojne te pershtatshme, cdo aksion mbi te cilat Shoqeria ka barre, por asnje shitje nuk do te behet , pervec kur nje shume ne lidhje me te cilen ekziston barra, eshte momentalisht e pagueshme dhe deri pas skadimit te 14 diteve pas njoftimit me shkrim, qe deklarone dhe kerkon pagimin e kesaj pjese te shumes ne lidhje me te cilen ekziston barra sic eshte momentalisht e pagueshme, i eshte dhene aksionerit te regjistruar , per momentin ose personat e titulluar per kete si rezultat i vdekjes ose falimentimit te tij.
15. Per ta sjelle ne fuqi nje shitje te tille, Drejtoret mund te autorizojne dike te transferoje aksionet e shitura bleresit. Bleresi do te regjistrohet si aksioner i aksioneve te perfshira ne cdo transferte te tille dhe nuk do jete i detyruar te kujdeset per perdorimin e parave te blerjes, as titulli i tij mbi aksionet nuk do te ndikohet nga cfaredo parregullsie apo pavlefshmerie ne procedurat ne lidhje me shitjen.
16. Te ardhurat nga shitja pas zbritjes se shpenzimeve, tarifave dhe komisionit te bera prej Shoqerise, Shoqeria do te marre dhe zbatoje pagimin e nje pjese te shumes ne lidhje me te cilen lieni ekziston sic eshte momentalisht i pagueshem, dhe mbetja do t'i ( subjekt i nje barre te ngjashme per shumat jo momentalisht te pagueshme sic ekzistonin mbi aksionet perpara shitjes) paguhet personit titullar te aksioneve ne daten e shitjes.

### **THIRRJE PER AKSIONET**

17. Drejtoret , here pas here, i bejne thirje Anetareve ne lidhje me para te paapguara per aksionet e tyre pjeserisht te paguara, dhe cdo Anetar do t'i ( ne varesi te marrjes se njoftimit te pakten prej 14 ditesh qe specifikon kohën ose kohet e pagimit) paguaje Shoqerise ne kohën ose kohet e specifikuara, shumën e kerkuar per keto aksione.
18. Aksioneret e perbashket te nje aksioni do te jene bashkarisht dhe vecas te pergjegjshem nga kjo.
19. Nese nje shume e kerkuar ne lidhje me nje aksion, nuk eshte paguar perpara ose ne ditën e caktuar per pagesën e saj, personi nga i cili pritët shuma do te paguaje interes mbi shumën me kurs 8 per qind ne vit nga dita e caktuar per pagesën deri ne kohën e vete pageses, por Drejtoret do te kene lirine per te shfuqizuar pagesën e interesit, ne teresi ose pjeserisht.



20. Dispozitat e ketyre Neneve ne lidhje me pergjegjesine e aksionereve te perbashket dhe ne lidhje me pagimin e interesit do te zbatohen ne rast mospagimi te cfaredo shume, e cila, nga termat e autorizimit te nje aksioni, behet e pagueshme ne nje kohe fikse, ne lidhje me shumen e aksionit ose me ane te premiumit, sikur e njejta te ishte bere e pagueshme si rezultat i nje thirrjeje te bere sipas rregullit dhe te njoftuar.
21. Drejtoret bejne pergatitje per ceshtjen e aksioneve pjeserisht te paguara per nje ndryshim mes Anetareve, ose te aksioneve te vecanta, ne shumen e thirrjeve per t'u paguar dhe ne kohet e pagimit.
22. Drejtoret mund, nese e mendojne te pershtatshme, te marrin nga cfaredo Anetar qe ka deshire te kaloje te njejten pjese, te gjitha ose te pjesshme, te parave te pathirrura dhe te papaguara ndaj cfaredo aksioni pjeserisht te paguar , te cilin ai mban, dhe ndaj te gjitha ose nje pjese te parave te dhena, mundet ( derisa e njetja gje, per nje dhenie te tille, behet momentalisht e pagueshme) te paguaje interes me kurs te tille ( pa kaluar tete perqind ne vit , pa sanksionin e nje Rezolute te Zakonshme) mbi te cilin mund te jete rene dakord mes Anetareve qe paguajne paraprakisht dhe Drejtoreve.

### **HUMBJA/KONFISKIMI I AKSIONEVE**

23. Nese nje Anetar nuk paguan cfaredo thirrje ose kest te nje thirrje ne lidhje me aksione pjeserisht te paguara ne ditet e caktuar per pagesen, Drejtoret mund, ne cdo kohe pas kesaj, qe cfaredo pjese e kesaj thirrjeje ose kesti mbetet i papaguar, t'i sherbejne nje njoftim qe kerkon pagesen e duhur te thirrjes ose kestit te papaguar, bashke me interesin qe mund t'i shtohet.
24. Njoftimi do te caktojte nje dite te metejshme (jo me heret se skadimi i 14 diteve nga data e njoftimit) ne ditet ose me perpara kohes ne te cilen pagimi i kerkuar ne njoftim duhet te behet, dhe do te deklaronte se ne rast mospagimi ne ose perpara kohes se caktuar, aksionet per cilat eshte bere thirrja , do te jene te konfiskueshme.
25. Nese kerkesat e nje njoftimi te tille si i lartepemenduri, nuk jane zbatuar, cfaredo aksioni ne lidhje me te cilin eshte dhene njoftimi, mundet, ne cdo kohe pas kesaj, perpara se pagimi i kerkuar ne njoftim te jete bere, te konfiskohet me ane te nje rezolute te Drejtoreve me efekt te tille.
26. Nje aksion i konfiskuar mund te shitet ose te hiqet ndryshe me terma dhe menyre te tille qe Drejtoret e shohin te pershtatshme, dhe ne cdo kohe perpara nje shitje apo heqjeje, konfiskimi mund te anulohet me terma qe Drejtoret konsiderojne te pershtatshem.

27. Nje person, aksionet e te cilit jane konfiskuar do te pushoje se qeni Anetar ne lidhje me aksionet e konfiskuara, por, pavaresisht nga kjo, do te mbetet pergjegjes per t'i paguar Shoqerise te gjitha parate, te cilat ne daten e konfiskimit, ishin te pagueshme nga ai ndaj Shoqerise ne lidhje me aksionet e konfiskuara, por pergjegjesia e tij do te mbaroje nese dhe kur Shoqeria merr pagesen e plote te shumes se papaguar te aksioneve te konfiskuara.
28. Nje deklarate statutore me shkrim qe deklaruesi eshte Drejtor, dhe qe nje aksion eshte konfiskuar ne perputhje me rregullat ne nje date te deklaruar ne deklarate, do te jete evidence konkluzive e fakteve ne deklarate kundrejt te gjithe personave qe pretendojne te jene titullare te aksionit.
29. Shoqeria mund te marre konsiderimin e dhene per nje aksion mbi cfaredo shitje ose heqje ne vijim te dispozitave te ketyre Neneve mbi konfiskimin dhe mund te ekzekutoje nje transferte te aksionit ne favor te personit te cilit i eshte shitur apo hequ aksioni dhe ky person do te jete i regjistruar si mbajtesi i atij aksioni dhe nuk do te jete i detyruar te kujdeset pr zbatimin e parave te blerjes dhe as titulli i tij ndaj aksioneve nuk do te ndikohet nga ndonje parregullsi ose pavlefshmeri ne procesin ne lidhje me heqjen ose shitjen.
30. Dispozitat e ketyre Neneve mbi konfiskimin do te zbatohen ne rast mospagimi te cfaredo shume e cila, me ane te termave te autorizimit te aksioneve, behet e pagueshme, ne lidhje me shumen e aksionit ose me ane te premiumit, sikur e njejta te kish qene e pagueshme me ane te nje thirrjeje te bere ne perputhje me rregullat dhe te njoftuar.

## TRANSFERTA E AKSIONEVE

31. Instrumenti i transfertes te cfaredo aksioni do te jete ne cfaredo forme te zakonte ose te zakonshme ose ne cfaredo forme tjeter qe Drejtoret miratojne ne diskrecionin e tyre te plote, dhe do te ekzekutohet nga ose ne emer te transferuesit dhe nese, ne lidhje me nje aksion nul ose pjeserisht te paguar, ose nese e kerkuar nga Drejtoret, do te ekzekutohet ne emer te transfertemarresit, do te shoqerohet nga certifikata e aksioneve me te cilat lidhet dhe cfaredo evidence tjeter qe Drejtoret mund te kerkojne arsyeshmerisht per te treguar te drejten e transferuesit per te bere transferen. Transferuesi do te mendohet se mbetet mbajttes i aksionit deri sa emri i transfertemarresit eshte futur ne Regjistrin e Anetareve ne lidhje me kete.
32. Drejtoret munden, ne diskrecionin e tyre te plote, te mos regjistrojne cfaredo transferte te aksioneve pa dhene asnje arsye per kete. Nese Drejtoret refuzojne te regjistrojne transferen e cfaredo aksioneve, ata, brenda dy muajve, pas dates ne te cilen eshte depozituar transferta me Shoqerine, do t'i dergojne transfertemarresit njoftimin e refuzimit.

33. Regjistrimi i transfertave mund të pezullohet në kohë dhe periudha të tilla që Drejtoret mund të përcaktojnë në diskrecionin e tyre të plotë, dhe kohë pas kohë, gjithmone me kusht që regjistrime të tilla nuk do të pezullohen për më shumë se 45 ditë në vit.
34. Të gjitha instrumentet e transferes që janë të regjistruara, do të mbahen nga Shoqëria, por çdo instrument i transferes që Drejtoret refuzojnë të regjistrojnë (përvetse në rastet mashtrimi) do t'i kthehen personit që depoziton atë.

### **EMETIMI I AKSIONEVE**

35. Përfaqesuesi ligjor personal i një aksioneri të vetëm të vdekur të një aksioni do të jetë personi i vetëm i njohur nga Shoqëria që ka titull mbi aksionin. Në rastin kur aksioni është regjistruar në emrin e dy ose më shumë aksionereve, të mbijetuarit ose i mbijetuari, ose përfaqesuesi ligjor personal i të mbijetuarit të vdekur, do të jetë i vetmi person i njohur nga Shoqëria që të ketë titull mbi aksionin.
36. Çdo person i titulluar për një aksion, si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një Anetari do të, mbi evidencë e prodhuar që mund të kërkojë herë pas here nga Drejtoret, të ketë të drejtën që ose të regjistrohet si Anetar në lidhje me aksionin, ose, në vend që të jetë i regjistruar vete, të bëjë një transfer të tillë të aksionit që do të kishte mundur të bënte personi i vdekur ose i falimentuar; por Drejtori, do të, në çfarëdo rast, të ketë të drejtën të refuzojë ose pezullojë regjistrimin, sikurse do të kishin bërë në rastin e transferes të aksionit nga i vdekuri ose personi i falimentuar përpara vdekjes ose falimentimit.
37. Një person që bëhet titullar i një aksioni si rezultat i vdekjes ose falimentimit të aksionerit, do të jetë i titulluar për të njëjtet dividende dhe avantazhe të tjera për të cilët ai do të ishte i titulluar nëse ai do të ishte aksioneri i regjistruar i aksionit, vetëm nëse ai nuk do të, përpara se të regjistrohet si Anetar në lidhje me aksionin, të jetë i titulluar në lidhje me të, të ushtronte çfarëdo të drejtë të dhënë nga anetarizimi në lidhje me mbledhjet e Shoqërisë.

### **NDRYSHIMI I KAPITALIT**

38. Shoqëria, mund, që herë pas here me anë të një Rezolutive të Zakonshme, rrisë kapitalin e aksioneve me një shumë që ndahet në aksione të klasave dhe shumave të tilla sikurse do të parashikojë Rezoluta.
39. Shoqëria mund, me anë të një Rezolutive të Zakonshme të:
  - (a) konsolidojë dhe ndajë të gjitha ose çfarëdo nga kapitali i saj i aksioneve në aksione të shumave me të mëdha se aksionet e saj ekzistuese;

- (b) konvertoje te gjitha ose cfaredo nga aksionet e saj te paguara ne stok dhe te rikonvertoje ate stok ne aksione te paguara te cfaredo vlere;
  - (c) nendaje aksionet e saj ekzistuese, ose cfaredo prej tyre ne aksione te shumave me te vogla me kusht qe ne nendarjen, raporti midis shumes se paguar dhe shumes se papaguar mbi secilin aksion te reduktuar do te jete i njejti me ate cka ishte ne rastin kur aksioni nga i cili rrodhi aksioni i reduktuar;
  - (d) anulloje cdo aksion qe , ne daten e kalimit te rezolutes, nuk eshte marre ose nuk eshte rene dakort te merret nga cfaredo personi dhe ule shumen e kapitalit te aksioneve te saj nga shuma e aksioneve te anuluar.
40. Shoqeria mund, me ane te Rezolutes Speciale, te reduktoj kapitalin e saj te aksioneve dhe cfaredo rezerve riblerje kapitali ne cfaredo menyre te autorizuar me ligj.

### **RIBLERJA DHE BLERJA E AKSIONEVE TE VETA**

41. Ne varesi te dispozitave te Ligjit te Shoqerive, Shoqeria mund te:
- (a) autorizoj aksione ne terma qe ato te riblen ose te jene te ribleshme si opsion i Shoqerise ose Anetarit me terma dhe menyre te tille qe mund te percaktojne Drejtoret perpara autorizimit te ketyre aksioneve;
  - (b) bleje aksionet e veta ( perfshire cfaredo aksione te ribleshme) ne terma dhe menyre te tille qe mund te percaktojne Drejtoret dhe te bien dakort me Anetarin; dhe
  - (c) beje nje pagese ne lidhje me riblerjen ose blerjen e aksioneve te veta pervec nga fitimet ose te ardhurat nga nje autorizim i fresket aksionesh.
42. Cdo aksion ne lidhje me te cilin eshte dhene njoftim riblerjeje, nuk do te jete i titulluar te marre pjese ne fitimet e Shoqerise ne lidhje me periudhen pas dates se specifikuar si data e riblerjes ne njoftimin e riblerjes.
43. Riblerja ose blerja e cfaredo aksioni nuk do te konsiderohet se leshon riblerjen ose blerjen e aksioneve te tjera.
44. Drejtoret mund, kur bejne pagesa ne lidhje me riblerjen ose blerjen e aksioneve, nese te autorizuar nga termat e autorizimit te aksioneve te riblera ose blera ose me marreveshje te mbajtesve te ketyre aksioneve, te bejen pagesa te tilla ne kesh apo te vogla.

### **REGJISTRI MBYLLES I ANETAREVE OSE DATA E FIKSUAR E REGJISTRIMEVE**

45. Per qellim te percaktimit te atyre Anetareve qe jane te titulluar te marrin njoftimi te, asistojne ose votojne ne cilendo nga mbledhjet e Anetareve ose te ndonje azhurnimi te tyre, ose ata Anetare qe jane te tilluar te marrin pagese ose dividende, ose per te bere nje percaktim, Drejtoret mund te parashikojne qe Regjistri i Anetareve do te mbyllet per transferta per nje periudhe te dhene qe nuk do t'i kaloje te 40 ditet. Nese Regjistri i Anetareve do te mbyllet keshtu per qellimin e percaktimit te ketyre Anetareve qe jane te titulluar te marrin njoftim, asistojne ose votojne ne nje mbledhje te Anetareve, regjistri do te mbyllet keshtu per te pakten 10 dite menjehere perpara kesaj mbledhje dhe dita e regjistrimit per kete percaktim do te jete data e mbylljes se Regjistrimit te Anetareve.
46. Ne vend te ose pervec mbylljes se Regjistrimit te Anetareve, Drejtoret mund te fiksojne paraprakisht nje date si data e regjistrimit per cfaredo percaktimi te atyre Anetareve qe jane te titulluar te marrin njoftim, asistojne ose votojne ne mbledhjet e Anetareve dhe per qellimin e percaktimit te atyre Anetareve qe jane te titulluar te marrin pagese nga cod dividende, Drejtoret mund, per ose brenda 90 diteve perpara dates ose deklarates te nje dividendi te tille, te fiksojne nje date vijuese si dite regjistrimi per kete percaktim.
47. Nese Regjistri i Anetareve nuk eshte mbyllur dhe nuk eshte fiksuar date regjistrimi per percaktimin e atyre Anetareve te titulluar te marrin njoftim, asistojne ose votojne ne mbledhjet e Anetareve dhe per qellimin e percaktimit te atyre Anetareve qe jane te titulluar te marrin pagese nga nje dividend, data ne te cilen jepet njoftimi i mbledhjes ose data ne te cilen rezoluta e Drejtoreve qe deklararon kete dividend, eshte adoptuar, sipas rastit, do te jete dita e regjistrimit per percaktimin e Anetareve. Kur percaktimi i atyre Anetareve te titulluar te marrin njoftim, asistojne ose votojne ne mbledhjet e Anetareve, eshte bere sic eshte parashikuar ne kete Nen, ky percaktim do te zbatohet ne cdo azhurnim qe del nga ketu.

### **MBLEDHJET E PERGJITHSHME**

48. Drejtoret mund, kurdo ta mendojne te pershtatshme, mblidhen ne nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise.
49. Mbledhjet e pergjithshme do te mblidhen gjithashtu sipas kerkeses me shkrim te cfaredo Anetari te titulluar te asistojne dhe votoje ne mbledhjet e pergjithshme te Shoqerise dhe qe mbajne jo me pak se 10 perqind te kapitalit aksionet te paguara te votimit te Shoqerise te depozituara ne zyren e regjistrimit te Shoqerise duke specifikuar qellimet e mbledhjes per nje date jo me vone se 21 dite nga data e depozitimit te kerkeses se firmosur nga kerkuesit, dhe nese Drejtoret nuk mblidhen ne nje mbledhje te tille, kerkuesit mund te mblidhen vete ne nje mbledhje te pergjithshme ne te njejten menyre, sa me afer qe te jete e mundur me aty ku mbledhjet e pergjithshme mund te mblidheshin nga Drejtoret, dhe te gjitha

shpenzimet e arsyeshme e bera nga kerkuesit si rezultat i mosmbledhjes se Drejtoreve te mbledhjes se pergjithshme, do t'u rimbursohen nga Shoqeria.

50. Nese, ne cfaredo kohe, nuk ka Drejtore, cdo dy Anetare (ose nese ka vetem nje Anetar, atehere ai Anetar) te titulluar te votojne ne mbledhjet e pergjithshme te Shoqerise ne menyre te njejte dhe sa me afer qe te jete e mundur ku mbledhja mund te mbledhet nga Drejtoret.

### **NJOFTIM I MBLEDHJEVE TE PERGJITHSHME**

51. Te pakten shtate dite lajmerim, duke numeruar nga data kur sherbimi mendohet te kryhet, sic eshte parashikuar ne keto Nene, qe specifikojne vendin, ditën dhe oren e mbledhjes, dhe ne rastin e nje biznesi special, natyren e pergjithshme te atij biznesi, do te jepet ne menyren e parashikuar ketu ose ne menyra te tjera te tilla sic mund te jene pershkruar ne Rezoluten e Zakonshme te Shoqerise, personave qe jane te titulluar, sipas ketyre Neneve, te marrin njoftime te tilla nga Shoqeria, por me pelqimin e te gjithë Anetareve te titulluar te marrin njoftime per mbledhje te caktuara, te asistojne dhe votojne atje, ajo mbledhje mund te mbledhet me ane te njoftimi me te shkurter ose pa njoftim dhe ne menyre te tille qe ata Anetare mund ta konsiderojne te pershtatshme.
52. Perjashtimi aksidental per te dhene njoftim te nje mbledhjeje ose mosmarrja e njoftimit te mbledhjes nga cfaredo Anetari, nuk do te cvleftesoje veprimet e asnje mbledhjeje.

### **VEPRIMET NE MBLEDHJET E PERGJITHSHME**

53. Te gjitha punet e kryera ne nje mbledhje te pergjithshme do te mendohen si speciale me perjashtimin e sanksionimit te nje dividenti, konsiderimin e llogarive, bilancet, dhe cdo raport te Drejtoreve ose te auditoreve te Shoqerise, emerimin dhe heqjen e Drejtoreve dhe caktimin e pageses se auditoreve te Shoqerise. Asnje biznes special nuk do te perfundohet ne mbledhjet e pergjithshme pa pelqimin e te gjithë Anetareve te titulluar te marrin njoftim te asaj mbledhjeje, vetem nese njoftimi per biznesin special eshte dhene ne njoftimin e asaj mbledhjeje.
54. Asnje pune nuk do te perfundohet ne asnje mbledhje te pergjithshme vetem nese nje kuorum Anetaresh eshte prezent ne kohen kur mbledhja vepron ne lidhje me kete biznes. Pervec se kur eshte parashikuar ndryshe ne keto Nene, nje ose me shume Anetare qe mbajne te pakten nje shumice te kapitalit te paguar votues te aksioneve te Shoqerise, prezente vete ose me ane te perfaqesise, do te jete nje kuorum.
55. Nese, brenda nje gjysem ore nga koha e caktuar per mbledhjen, nje kuorum nuk eshte prezent, mbledhja nese e mbledhur sipas kerkeses te Anetareve, do te shperndahehet. Ne cdo rast tjetër, do te azhornohet prej nje jave ne te njejtën dite,

- kohe dhe vend, dhe nese ne ate mbledhje te azhornuar, nuk ka prezent nje kuorum brenda nje gjysem ore nga koha e caktuar per mbledhjen, Anetari ose Anetaret e pranishem dhe te titulluar te votojne do te perbejne kuorumin.
56. Nese Drejtoret deshirojne ta bejne kete lehtesi te disponueshme per Anetaret per te gjitha apo nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise, nje Anetar mund te marre pjese ne cfaredo mbledhje te pergjithshme te Shoqerise, me ane te nje telefoni ose pajisje te ngjashme komunikimi me ane te se ciles te gjithë personat qe marrin pjese ne nje mbledhje te tille, mund ta degjojne njeri-tjetrin dhe nje pjesemarrje e tille do te mendohet se perben presencen e vete personit ne mbledhje.
  57. Kryetari i Keshillit Drejtues do te ulet si kryetar ne cdo mbledhje te pergjithshme te Shoqerise.
  58. Nese nuk ka nje kryetar te tille, ose nese ne nje mbledhje te pergjithshme ai nuk eshte prezent brenda pesembedhete minutave pas kohes se caktuar per mbajtjen e mbledhjes ose nuk ka deshire te veproje si kryetar, Anetaret e pranishem do te zgjedhin nje nga vete ata per te qene kryetari i asaj mbledhjeje.
  59. Kryetari mund, me pelqimin e cfaredo mbledhjeje te pergjithshme ne te cilen eshte i pranishem nje kuorum (dhe do te, nese e udhezuar keshtu nga mbledhja) azhornoje nje mbledhje here pas here dhe nga vendi ne vend, por asnje pune nuk do te perfundohet ne cfaredo mbledhje te azhornuar pervec puneve te lena te pambaruara ne mbledhjen nga e cila u be azhornimi. Kur nje mbledhje eshte e azhornuar per 14 dite ose me shume, do te jepet njoftim i mbledhjes se azhornuar sikurse ne rastin e nje mbledhjeje orgjinale. Pervec se me siper, nuk do te jete e nevojshme te jepet njoftim i cfaredo azhornimi ose i puneve te perfunduara ne mbledhjen e azhornuar.
  60. Ne cfaredo mbledhje te pergjithshme , nje rezolute e hedhur per votim do te vendoset me tregimin e duarve, pervec kur kerkohet perfaqesia ( perpara ose ne kohen e deklarimit te rezultateve te tregimit te duarve) nga je ose me shume Anetare te pranishem ose me ane te perfaqesise, te titulluar per te votuar, dhe pervec kur kerkohet votimi, nje deklarate nga kryetari qe nje rezolute, ka, sipas tregimit te duarve, kaluar ose eshte kaluar unanimisht, ose me ane te nje shumice te caktuar, ose humbur, dhe nje hyrje me kete efekt ne librin e veprimeve te Shoqerise, do te jete konkluduese sipas evidences se fakteve, pa prove te numrit ose raportit te votave te regjistruara ne favor te, ose kundra asaj rezolute.
  61. Nese nje votim eshte kerkuar sipas rregullave, do te kryhet ne menyre te tille sic udhezohet nga kryetari, dhe rezultati i votimit do te mendohet te jete rezolute e mbledhjes ne te cilen u kerkua votimi.
  62. Ne rastin e barazise se votave, me tregim duarsh ose votim, kryetari i mbledhjes ne te cilen behet tregimi i duarve ose kur votimi eshte kerkuar, do te jete i titulluar per te hedhur nje votim te dyte.

63. Nje votim i kerkuar per zgjedhjen e kryetarit te mbledhjes ose per ceshtjen e azhornimit, do te kryhet per kete qellim. Votimi i kerkuar per cfaredo ceshtje tjeter do te kryehet ne nje kohe te tille qe udhezohet nga kryetari i mbledhjes se pergjithshme.

### VOTAT E ANETAREVE

64. Ne varesi te drejtave dhe kufizimeve per nje kohe te caktuar te dhena nje klase ose klasash aksionesh, me tregim duarsh, cdo Anetar i pranishem dhe cdo person qe perfaqeson nje Anetar me ane te perfaqesise do te, ne nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise, kete nje vote, dhe ne nje votim, cdo Anetar dhe cdo person qe perfaqeson nje Anetar me ane te perfaqesise do te kete nje vote per cdo aksion per te cilin ai ose personi i perfaqesuar me ane te perfaqesise eshte aksioner.
65. Ne rastin e aksionereve te perbashket, vota e me te vjetrit qe propozon voten ne person ose me ane te perfaqesise, do te pranohet ne perjashtim te votave te aksionereve te perbashket dhe per kete qellim, vjetersia do te percaktohet sipas rradhes ne te cilen vendosen emrat ne Regjistrin e Anetareve.
66. Nje Anetar i nje mendjeje jo te shendoshe, ose ne ne lidhje me te cilin eshte leshuar nje urdher nga nje gjykate qe ka ne juridiksion marrezine, mund te votoje, me ane te tregimit te duarve ose votimit, me ane te komitetit te tij, ose cdo personi tjeter ne natyren e nje komiteti te caktuar nga gjykata, dhe cdo komitet i tille ose person mund te votoje me ane te perfaqesise.
67. Asnje anetar nuk do te jete i titulluar te votoje ne asnje mbledhje te pergjithshme, pervec kur te gjitha thirrjet ose shuma te tjera momentalisht te pagueshme prej tij ne lidhje me aksionet qe mbartin te drejtene tij per te votuar, jane paguar.
68. Ne nje votim, votat mund te jepen personalisht ose me ane te perfaqesise.
69. Instrumenti qe cakton perfaqesine do te jete me shkrim nga dora e caktuesit ose perfaqesuesit te tij te autorizuar me shkrim sipas rregullave ose, nese caktuesi eshte corporate, me ane te vules ose nen doren e nje zyrtari ose perfaqesuesi te autorizuar sipas rregullave. Perfaqesuesi nuk eshte e nevojshme te jete Anetar.
70. Nje instrument qe cakton nje perfaqesues mund te jete ne cfaredo forme te zakonshme ose ne cfaredo forme tjeter qe mund te aprovojne Drejtoret.
71. Instrumenti qe cakton nje perfaqesues do te mendohet te jape te drejten per te kerkuar ose per t'u bashkuar ne kerkesen per nje votim.
72. Nje rezolute me shkrim e firmosur nga te gjithe Anetaret, momentalisht te titulluar te marrin njoftim per dhe qe te asistojne dhe votojne ne mbledhje te pergjithshme (ose kur jane korporata, nga perfaqesuesit e tyre te autorizuar sipas



rregullave) do te jete po aq e vlefshme dhe effective sikur te ishte kaluar ne nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise te mbledhur dhe mbajtur sipas rregullave.

### **KORPORATAT QE VEPROJNE ME ANE TE PERFAQESUESVE NE MBLEDHJE**

73. Cdo corporate qe eshte Anetar ose Drejtor mund, me ane te rezolutes te drejtoreve te saj ose cdo trupi tjeter qeverises, te autorizojte nje person qe e mendon te pershtatshem si perfaqesuesi te saj ne cfaredo mbledhje te Shoqerise ose cfaredo klase Anetaresh ose te Keshillit Drejtues ose te nje komitetit te Drejtoreve, dhe personi i autorizuar do te jete i titulluar te ushtroje te njejta kompetenca ne emer te korporates qe ai perfaqeson , qe korporata mund te ushtronte nese do te ishte nje Anetar individual ose Drejtor.

### **DREJTORET**

74. Emri i Drejtorit ( Drejtoreve) te pare do te percaktohet me shkrim ose me shumice ( ose ne rastin e nje nenshkruesi te vetem, te atij nenshkruesi) te , ose i zgjedhur ne nje mbledhje te nenshkruesve te Aktit te Themelimit.
75. Shoqeria mund, me ane nje Rezolute te Zakonshme, te caktojte nje person si Drejtor.
76. Ne varesi te dispozitave te ketyre Neneve, nje Drejtor do ta mbaje postin deri ne kohen qe ai hiqet nga posti nga Shoqeria me Rezolute te Zakonshme.
77. Shoqeria mund, me Rezolute te Zakonshme, here as here, te caktojte numrin maksimal dhe minimal te Drejtoreve per t'u emeruar, por pervec kur ky numer eshte caktuar si me lart, numri i Drejtoreve do te jete i pakufizuar.
78. Paga e Drejtoreve mund te percaktohet nga Keshilli Drejtues ose nga Shoqeria me Rezolute te Zakonshme.
79. Nuk do te kete kualifikim aksionmbajtes per Drejtoret, pervecse kur eshte percaktuar ndryshe nga Shoqeria me Rezolute te Zakonshme.
80. Drejtoret do te kene kompetencen ne cdo kohe, dhe here pas here, te emerojne nje person si Drejtor, si rezultat i nje vendi te lire te rastesishem oe si nje Drejtor shtese, ne varesi te numrit maksimal te vene nga Shoqeria me Rezolute te Zakonshme.

### **DREJTORET E NDRYSHEM**

81. Cdo Drejtor, mund te emeruje me shkrim nje person tjeter per te qene zevendesuesi i tij per te vepruar ne vend te tij ne cfaredo mbledhje te Drejtoreve

net e cilen ai nuk eshte ne gjendje te jete i pranishem. Cdo zevendesues i tille do te jete i titulluar te marre njoftime te mbledhjeve te Drejtoreve dhe te asistojte dhe votoje atje si Drejtor kur personi qe e ka emeruar nuk eshte personalisht i pranishem dhe ku ai eshte Drejtor qe ka vote te vecante ne emer te Drejtorit qe ai perfaqeson pervec votes se tij. Nje Drejtor, mund ne cdo kohe, ta revokojte me shkrim emerimin e drejtorit zevendesues te bere prej tij. Ky zevendesues nuk do te jete punonjes i Shoqerise dhe do te mendohet te jete agjent i Drejtorit qe e emerion. Paga e zevendesuesit do te jete e pagueshme nga paga e Drejtorit qe e emerion dhe per pejsen perkatese do te biet dakort mes tyre.

82. Cdo Drejtor mund te emeruje cdo person, Drejtor ose jo, te jete perfaqesuesi i atij Drejtorit per te asistuar dhe votuar ne emer te tij, ne perputhje me udhezime te dhena nga ai Drejtor, ose ne mungese te udhezimeve te tilla, ne diskrecion te perfaqesuesit, ne nje mbledhje ose mbledhje te Drejtoreve qe ai Drejtor nuk eshte ne gjendje te asistojte personalisht. Instrumenti qe emerion perfaqesuesin do te jete me shkrim nen doren e Drejtuesit emerues dhe do te jete ne cfaredo forme te zakonshme ose forme tjeter qe mund te aprovojne Drejtoret, dhe duhet te depozitohet me kryetarin e mbledhjes se Drejtoreve ne te cilen kjo perfaqesi do te perdoret, ose perdoret per here te pare, perpara fillimit te mbledhjes.

### **TE DRJTAT DHE DETYRAT E DREJTOREVE**

83. Ne varesi te dispozitave te Ligjit te Shoqerive, ketyre Neneve dhe cdo resolute te bere ne nje mbledhje te pergjithshme, puna e Shoqerise do te drejtohet nga Drejtoret, qe mund te paguajne te gjitha shpenzimet e bera per krijimin dhe regjistrimin e Shoqerise dhe mund te ushtrojne te gjitha kompetencat e Shoqerise. Asnje resolute e bere nga Shoqeria ne mbledhjen e pergjithsme do te shvlefte ajo aktet e meparshme te Drejtoreve qe do te kishin qene te vlefshme nese ajo resolute nuk do te ishte bere.
84. Drejtoret, here pas here mund te mendojne cfaredo personi, Drejtor ose jo, te mbaje nje post te tille ne Shoqeri qe Drejtoret mund ta mendojne te nevojshem per administrimin e Shoqerise, perfshire, por duke mos u kufizuar me, postin e presidentit, nje ose me shume nenepresidente, arketar, ndihmes arketat, menaxher ose kontrollor, dhe me kohezgjatje te tille dhe page te tille ( me roge ose komision ose pjesemarrje ne fitime ose pjeserisht ne nje formed dhe pjeserisht ne tjetren) dhe me te drejta dhe detyra qe Drejtoret mendojne te pershtatshme. Cdo person i tille i emeruar nga Drejtoret mund te hiqet nga Drejtoret. Drejtoret mund te emerojne gjithashtu, nje ose me shume nga ata vete ne postin e Drejtorit menaxhues me term ate ngjashme, por nje emerim i tille do te percaktonte ispo facto nese nje drejtor menaxhues do te pushonte, nga cfaredo shkak, se qeni Drejtor ose nese Shoqeria me Rezolute te Zakonshme vendos qe kohembajtja e tij e postit te perfundohet.

85. Drejtoret mund te emerojne nje Sekretar ( dhe nese eshte nevoja nje Ndhimes Sekretar ose Ndhimes Sekretare) qe do te mbaje postin per nje kohe te tille dhe pagese te tille dhe me kushte dhe te drejta te tilla qe ata shohin te pershtatshem. Cdo Sekretar ose Ndhimes Sekretar i emeruar keshtu nga Drejtoret mund te hiqet nga Drejtoret.
86. Drejtoret mund te delegojne cfaredo nga te drejtat e tyre komiteteve te perbere nga anetar ose anetare te tille te trupit te tyre qe ata shohin te pershtatshem ; cdo komitet i formuar keshtu do te, ne ushtimin e kompetencave te deleguara ne perputhje me rregulloret qe mund te vihen mbi komitetin nga Drejtoret.
87. Drejtoret, mund, here pas here dhe ne cdo kohe, me ane te prokures te emerojne cfaredo shoqerie, firme, personi ose trup personash, te nominuar drejtperdrejt ose ne menyre jo te drejteperdrejte nga Drejtoret, te jete perfaqesuesi ose perfaqesuesit e Shoqerise per qellime te tilla dhe me kompetenca te tilla, te drejta dhe diskrecion ( qe nuk tejkalojne ato te veshura apo te ushtrueshme nga Drejtoret sipas ketyre Neneve) dhe per nje periudhe te tille dhe ne varesi te kushteve qe ata mund te konsiderojne te pershtatshme, dhe cdo procure e tille mund te permbaje dispozita te tilla per mbrojtjen dhe interesat e personave qe merren me kete perfaqesues sikurse Drejtoret mund ta konsiderojne te pershtatshem, dhe mund gjithashtu, te autorizojne keta perfaqesues qe te delegojne te gjitha ose cdonje nga kompetencat e tij, te drejtat dhe diskrecionin e veshur ne te.
88. Drejtoret, here pas here, mund te marrin masa per drejtimin e puneve te Shoqerise ne ate menyre qe ata e mendojne te pershtatshme dhe dispozitat qe permbahen ne te Nenet qe vijojne nuk do t'i kufizojne kompetencat e pergjithshme te akorduara nga ky Nen.
89. Drejtoret, here pas here, dhe ne cdo kohe, mund te ngrene komitete, borde ose agjente lokale per menaxhimin e cdonjeres prej paneve te Shoqerise dhe mund te caktojne cdo person qe te jete anetar i ketyre komiteteve ose bordeve lokale dhe mund te caktojne menaxhere ose agjente te Shoqerise dhe mund te vendosin pagimin e ketyre personave.
90. Drejtoret, here pas here, dhe ne cdo kohe, mund t'i delegojne ketyre komiteteve, bordet lokal, menaxherit ose agentit cdonje prej fuqive, autoriteteve dhe kompetencave gjate kohes qe ato i perkasin Drejtoreve dhe mund te autorizojne anetarit gjate kohes se ekzistences te ketij bordi lokal ose ndonjerit prej tyre, per te mbushur pozicionet e lira aty dhe te veprojne, pavaresisht nga keto vende te lira publike dhe cdonjeri prej ketyre emerimeve ose delegimeve behet sipas atyre termave dhe kushteve qe Drejtoret i mendojne te pershtatshme dhe Drejtoret mund te qe ne cdo kohe ta largojne ndonje person te emeruar ne kete menyre dhe mund ta anullojne ose ndryshojne cdo delegim te tille, por kjo nuk do te cenoje asnjehere person me qellim te mire dhe pa u njoftuar per keto anulim ode ndryshim.

91. Cdonje prej ketyre te deleguarve, sic eshte thene me siper, mund te autorizohet nga Drejtoret qe ten. en-delegoje te gjithë ose ndonje nga fuqite, autoritetet dhe kompetencat gjate kohes qe ato i perkasin atij.

### **KOMPETENCAT E DREJTOREVE PER TE MARRE HUA**

92. Drejtoret mund t'i ushtrojne te gjitha kompetencat e Shoqerise per te marre hua ne te holla dhe per te hipotekuar ose barresuar ndermarrjen e saj, pronen dhe kapitalin e pathirrrur ose ndonje pjese te tij, per te leshuar obligacione, mall borxh ose letra te tjera te cmuara, cdo here qe te holla merren hua ose si siguri per ndonje borxh, pergjegjesi ose detyrim te Shoqerise ndaj paleve te treta.

### **VULA**

93. Vula nuk do t'i vihet asnje instrumenti, pervecse me autoritetin e rezolutes se Keshillit Drejtues gjithnje me kusht qe nje autoritet i tille mund te jepet para ose pas venies se Vules dhe ne qofte se jepet pas mund te jete ne forme te pergjithshme qe konfirmon nje numer venie Vulash. Vula do te vendoset ne pranine e nje Drejtori ose Sekretari (ose te nje Asistent Sekretari) ose ne prani te nje ose me shume personave te caktuar per kete qellim nga Drejtoret dhe cdo person, sic eshte thene me siper, do te firmose cdo instrument te cilit i eshte vene Vula ne prani te tij.
94. Shoqeria mund te mbaje nje riprodhim te Vules ne ato shtete dhe vende qe caktojne Drejtoret dhe ky riprodhim i Vules nuk do t'i vihet asnje instrumenti pervecse me autoritetin e nje rezolute te Keshillit Drejtues gjithnje me kusht qe nje autoritet i tille mund te jepet para ose pas venies se Vules se riprodhuar dhe ne qofte se jepet pas mund te jete ne forme te pergjithshme qe konfirmon nje numer venie Vulash te riprodhuara. Vula e riprodhuar do te vihet ne pranine e atij personi ose personave qe Drejtoret do te caktojne per kete qellim dhe ky person apo keta pesona, sic premendet me lart, do te firmosin cdo instrument te cilit i eshte vene vula e riprodhuar ne pranine e tyre dhe kjo veie e Vules se riprodhuar dhe nenshkrimi i lartpermendur do te kene te njejtin kuptim dhe efekt sikurse Vula te ishte vendosur ne pranine dhe instrumenti te ishte firmosur nga nje Drejtor ose nje Sekretar (ose nje Asistent Sekretar) ose ne pranine e nje ose me shume personave qe Drejtoret mund te caktojne per kete qellim.
95. Pavaresisht nga sa me siper, nje Sekretar ose Asistent Sekretar do te kete autoritetin qe t'i vere Vulen, ose Vulen e riprodhuar, cdo instrumenti per qellimin e vertetimit te autencitetit te ceshtjes qe permbahet aty por e cila nuk krijon asnje detyrim lidhes mbi Shoqerine.

### **PERJASHTIMI I DREJTOREVE**

Posti i Drejtorit do te lihet, nese Drejtori:

- (a) falimenton ose ben ndonje marreveshje apo ujdj me kreditorët e tij;

- (b) vertetohet te jete ose behet me mendje te semure;
- (c) heq dore nga posti I tij duke njoftuar me shkrim Shoqerine;
- (d) largohet nga posti me Rezolute te Zakonshme; ose
- (e) largohet nga posti me njoftim ne adresen e tij te fundit qe dihet dhe te firmosuar nga te gjithë bashke-Drejtoret e tij (jo me pak se dy ne numer).

### **PROCEDURAT E DREJTOREVE**

97. Drejtoret mund te mblidhen se bashku (brenda ose jashte Ishujve Cayman) per ndarjen e detyrave, pezullimin dhe i rregullojne mbledhjet dhe procedurat e tyre sic i mendojne ata te pershtatshme. Pyetjet qe ngrihen ne mbledhje do te vendosen me shumice votash. Ne rast barazimi votash kryetari do te kete nje vote te dyte ose vendimtare. Drejtori, si edhe dhe nje Sekretar ose Asistent Sekretar me kerkesen e nje Drejtori, mund te therrase nje mbledhje Drejtoresh ne cdo kohe.
98. Drejtori ose Drejtoret mund te marrin pjese ne cdo mbledhje te Keshillit Drejtues, ose te cdo komiteti te caktuar nga Keshilli Drejtues ku Drejtori ose Drejtoret jane anetare, me ane te telefonit ose pajisje te ngjashme komunikimi me ane te te cileve te gjithë personat qe marrin pjese ne mbledhje te tilla mund ta degjojne njeri tjetrin dhe nje pjesemarrje e tille do te konsiderohet njelloj sikur ai person te ishte i pranishem ne mbledhje.
99. Kuorumi i nevojshem per kryerjen e aktivitetit te Drejtoreve mund te vendoset nga Drejtoret, dhe po te mos vendoset keshtu, nese jane dy ose me shume Drejtore kuorumi eshte dy, dhe nese eshte nje Drejtor kuorumi eshte nje. Drejtori i perfaqesuar nga nje i autorizuar ose nga nje Drejtor Alternativ do te konsiderohet sikur eshte i pranishem ne cdo mbledhje per te vendosur nese kuorumi eshte apo jo i pranishem.
100. Drejtori, i cili ne njefare menyre, qofte drepersedrejti apo jo, eshte i interesuar per nje kontrate ose per nje kontrate te propozuar me Shoqerine, duhet ta deklaroje natyren e interesit te tij ne mbledhjen e Drejtoreve. Nje njoftim i pergjithshem drejtuar Keshillit Drejtues nga ndonje Drejtor ku tregohet se ai eshte anetar i nje shoqerie apo firme te specifikuar dhe konsiderohet si i interesuar ne cdo kontrate qe me pas mund te lidhet me kete shoqeri apo firme, do te konsiderohet si deklarate e mjaftueshme interesi lidhur me cdo kontrate te tille qe mund te behet. Drejtori mund te votoje lidhur me cdo kontrate ose kontrate te propozuar ose marreveshje pavaresishte se aim und te kete interes aty dhe nese voton vota e tij do te numerohet dhe aim und te numerohet ne kuorumin e cdo mbledhje te Drejtoreve ku kjo kontrate ose kontrate e propozuar ose marreveshje do te paraqitet per t'u marre ne konsiderate.

101. Nje Drejtor mund te kete ndonje post ose vend tjeter fitimi ne Shoqeri (pervec postit te Ekspertit Kontabel) nderthurur me postin e Drejtorit per ate periudhe dhe ne ato kushte (si per pagesen dhe te tjera) qe vendosen nga Drejtoret dhe asnje Drejtor ose Drejtor i caktuar nuk do te perjashtohet nga posti i tij per kontraktimin me Shoqerine qofte ne lidhje me mbajtjen e ketij postit ose vendit tjeter te fitimit, qofte si shites, bleres, etj., dhe asnje kontrate e tille ose marreveshje e lidhur nga ose ne emer te Shoqerise ne te cilen ndonje Drejtor eshte i interesuar ne nje fare menyre, duhet te shmanget, dhe asnje Drejtor qe kontraktin ose eshte i interesuar ne kete menyre, do te jete pergjegjes ndaj Shoqerise per ndonje fitim te realizuar nga nje kontrate ose marreveshje e tille per shkak te ketij Drejtori qe mban ate post ose per arsye te lidhjes se mirebesimit qe ne kete menyre eshte vendosur. Nje Drejtor, pavaresisht nga interesi i tij, mund te numerohet ne kuorumin e praishem ne cdo mbledhje te Drejtoreve dhe nderkohe ai ose ndonje Drejtor tjeter eshte emeruar per te mbajtur nje post ose vend fitimi te tille ne Shoqeri ose nderkohe qe kushtet e ketij emerimi jane percaktuar dhe ai mund te votoje ne cdo emerim ose caktim te tille.
102. Cdo Drejtor mund te veproje nepermjet vetes se tij ose firmes me zotesi profesionale per Shoqerine, dhe ai ose firma e tij ka te drejte qe te paguhet per sherbimet profesionale sikur ai te mos ishte Drejtor; me kusht qe asgje qe permbahet ketu nuk e autorizon nje Drejtor ose firmen e tij qe te veproje si Ekspert Kontabel i Shoqerise.
103. Drejtoret do te bejne qe protokollet te mbahen ne librat ose ne dosjet me flete te pangjitura te dhena per te regjistruar:
- (a) te gjitha takimet e nepunesve te bera nga Drejtoret;
  - (b) emrat e Drejtoreve te pranishem ne cdo mbledhje Drejtoresh dhe ne cdo komitet Drejtoresh;
  - (c) te gjitha rezolutat dhe procedurat ne te gjitha mbledhjet e Shoqerise, dhe te Drejtoreve dhe te komiteve te Drejtoreve;
104. Kur kryetari i mbledhjes se Drejtoreve i nenshkruan protokollet e ketyre mbledhjeve, ato protokolle do te konsiderohen si te mbajtura sakte pavaresisht se jo te gjitha Drejtoret kane qene te nje mendje ose mund te kete patur ndonje defect teknik gjate procedures.
105. Nje rezolute e firmosur nga te gjitha Drejtoret do te jete po aq e vlefshme dhe efikase si te ishte miratuar ne mbledhjen e Drejtoreve te thirrur dhe te perbere sipas rregullit. Kur firmoset, nje rezolute mund te perbehet nga disa dokumente, secili prej te cileve firmoset nga nje ose me shume Drejtore.
106. Drejtoret ne vazhdimesi, mund te veprojne pavaresisht se ka ndonje vend bosh ne keshillin e tyre por ne qofte se dhe per aq kohe sa numri i tyre eshte zvogeluar

poshte numrit te vendosur nga ose sipas ketyre Neneve si kuorumi i nevojshem i Drejtoreve, Drejtoret ne vazhdim mund te veprojne per te rritur numrin, ose per te thirrur nje mbledhje te pergjithshme te Shoqerise, por jo per qellim tjeter.

107. Drejtoret mund te zgjedhin nje kryetar te mbledhjeve te tyre dhe te vendosin periudhen per te cilen ai do te qendroje por ne qofte se nuk zgjidhet nje kryetar i tille, ose ne ndonje mbledhje kryetari nuk eshte i pranishem per 15 minuta pas kohes qe ai duhet te jete ne mbledhje, Drejtoret e pranishem mund te zgjedhin nje prej tyre qe te jete kryetari i mbledhjes.
108. Komiteti i emeruar nga Drejtoret mund te zgjedhe nje kryetar per mbledhjet e tij. Ne qofte se nuk zgjidhet nje kryetar i tille, ose ne ndonje mbledhje kryetari nuk eshte i pranishem per 15 minuta pas kohes qe ai duhet te jete ne mbledhje, anetaret e pranishem mund te zgjedhin nje prej tyre qe te jete kryetari i mbledhjes.
109. Komiteti I emeruar nga Drejtoret mund te mblidhet dhe pezullohet si e mendon te pershtatshme. Ceshtjet qe ngrihen ne mbledhje do te vendosen me shumice votash te anetareve te komitetit qe jane te pranishem dhe ne rast barazim votash kryetari ka nje vote te dyte ose vendimtare.
110. Te gjitha veprimet e kryera ne nje mbledhje te Drejtoreve ose te komitetit te Drejtoreve, ose nga ndonje person qe kryen funksionin e Drejtorit, pavaresisht se me vone zbulohet se kishte mangesira ne caktimin e ketij Drejtori apo personi qe vepron sa me siper, ose pavaresisht se ata ose njeri prej tyre ishin te perjashtuar, do te jene te vlefshme sikur cdo person i tille te ishte caktuar sipas rregullit dhe te ishte i kualifikuar per te qene Drejtor.

## **DIVIDENDET**

111. Ne varesi te te drejtave dhe kufizimeve, per aq kohe sa ekzistojne, bashkengjitur ndonje klase apo klasave te aksioneve, Drejtoret, here pas here, mund te deklarojne dividendet (perfshire dividendet e perkohshem) dhe distribucione te tjera mbi aksionet e emetuara dhe te autorizojne pagimin e ketyre nga fondet e Shoqerise qe jane te disponueshme ne menyre te ligjshme.
112. Ne varesi te te drejtave dhe kufizimeve, per aq kohe sa ekzistojne, bashkengjitur ndonje klase apo klasave te aksioneve, Shoqeria, me ane te Rezolutes se Zakonshme, mund te deklaroje dividendet, por asnje dividend nuk do te kaloje shumen e sugjeruar nga Drejtoret.
113. Drejtoret, perpara se te rekomandojne apo deklarojne ndonje dividend, mund te heqin menjane per distribucion, nga fondet e disponueshme ne menyre te ligjshme, ato shuma qe atyre i duken te pershtatshme si rezerve ose rezerva te cilat, sipas kompetencave absolute te Drejtoreve, do te perdoren per te papriturat e mbledhjeve, ose per barazuar dividendet, ose per ndonje qellim tjeter per te cilin ato fonde mund te perdoren sic duhet dhe, duke pritur kete perdorim mund te

perdoren, sipas kompetencave absolute te Drejtoreve, per aktivitetin e Shoqerise ose te investohen ne ato investime (pervec aksioneve) qe here pas here i duken te pershtatshme Drejtoreve.

114. Cdo dividend mund te paguhet me çek te derguar me poste ne adresen e regjistruar te Anetarit ose personit qe i takon, ose ne rast te zoteruesve te perbashket, tek ndonjeri prej tyre ne adresen e tij te regjistruar, ose tek ai person dhe ne ate adrese qe jepet nga Anetari ose personi qe i takon, ose zoteruesit e perbashket, sipas rastit. Cdo çek i tille behet i pagueshem per personin qe i dergohet ose per ate person qe vendoset nga Anetari ose personi qe i takon, ose nga zoteruesit e perbashket, sipas rastit.
115. Drejtoret kur I paguajne dividendet Anetareve sipas dispozitave te ketyre Neneve, mund ta bejne kete pagese ose ne cash ose ne te vogla.
116. Ne varesi te te drejtave dhe kufizimeve, per aq kohe sa ekzistojne, bashkengjitur ndonje klase apo klasave te aksioneve, te gjithë dividendet do te deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per aksionet, por ne qofte se dhe per aq kohe sa asgje nuk eshte paguar per aksionet, dividendet mund te deklarohen dhe paguhen sipas vleres nominale te aksioneve.
117. Nese disa persona jane regjistruar si zoterues te perbashket te ndonje aksioni, cdonjeri prej tyre mund te jape fatura te vlefshme per cdo dividend ose te holla te tjera te pagueshme per ose lidhur me aksionin.
118. Asnje dividend nuk do te mbarte interes perkundrejt Shoqerise.

### **LLOGARITE DHE KONTROLI FINANCIAR**

119. Librat e llogarise per ceshtjet e Shoqerise do te mbahen sipas menyres qe vendoset here pas here nga Drejtoret.
120. Librat e llogarise do te mbahen ne zyren e regjistruar te Shoqerise, ose ne ate vend ose vende te tjera qe Drejtoret i mendojne te pershtatshem, dhe gjithmone do te jene te hapur per inspektim nga Drejtoret.
121. Drejtoret, here pas here, do te vendosin nese dhe deri ne cfare mase e ne cilen kohe dhe vende, si edhe sipas cila kushteve dhe rregulloreve llogarite dhe librat e Shoqerise ose ndonjeri prej tyre, do te hapen per inspektim nga Anetaret qe nuk jane Drejtore, dhe asnje Anetar (qe nuk eshte Drejtor) nuk ka te drejte te inspektoje ndonje llogari ose liber ose dokument te Shoqerise pervecse kur ju jepet kjo e drejte me ligj ose autorizohet nga Drejtoret ose nga Rezoluta e Zakonshme e Shoqerise.



122. Llogarite lidhur me punet e Shoqerise do te revizionohen vetem nese keshtu vendosin Drejtoret, me te cilin rast mbyllet viti financiar dhe principet e kontrollit financiar do te vendosen nga Drejtoret.

### **KAPITALIZIMI I FITIMEVE**

123. Ne varesi te Ligjit te Shoqerive, me autoritetin e nje Rezolute te Zakonshme, Drejtoret mund te:

- (a) vendosin te kapitalizojne nje shume qe eshte per rezervat (duke perfshire nje llogari e primit te aksioneve, rezerven e kompensimit te kapitalit dhe llogarine e fitimit dhe te humbjes), pavaresisht nese eshte apo jo e disponueshme per shpermdarje;
- (b) pershtasin shumen e vendosur per t'iu kapitalizuar Anetareve ne proporcion me shumen nominale te aksioneve (nese eshte paguar plotesisht ose jo) te zoteruara prej tyre respektivisht dhe ta aplikojne ate shume ne emer te tyre per ose drejt:
  - (i) pageses se shumave (nese ka) te papaguara per aksionet e zoteruara prej tyre respektivisht, ose
  - (ii) pageses se plote te aksioneve te pa-emetuara ose te obligacioneve te vleres nominale te barabarte me ate shume,

dhe t'ia caktojne aksionet ose obligacionet, te paraqitura si te paguara plotesisht, Anetareve (ose atyre qe caktojne ate) ne ato proporcione, ose pjeserisht ne nje menyre dhe pjeserisht ne nje tjetër, por llogaria e primit te aksioneve, rezerva e kompensimit te kapitalit dhe fitimet te cilat nuk jane ne dispozicion per t'u shpermdare, per qellimet e ketij Neni, mund te perdoret vetem per pagesen e aksioneve te pa-emetuara per t'iu dhene Anetareve, te paraqitura si plotesisht te paguara;

- (c) lidhin ndonje marreveshje qe ata e mendojne te pershtatshme per te zgjidhur nje veshtiresi qe lind ne shpermdarjen e nje reserve te kapitalizuar dhe ne vecanti, pa u kufizuar, aty ku aksionet ose obligacionet behen te shpermdashme ne fraksione, Drejtoret mund te marrin masa per fraksionet ashtu sic eshte me e pershtatshme per ta;
- (d) autorizojne nje person te hyje (ne emer te te gjithë Anetareve te interesuar) ne marreveshje me Shoqerine qe kane te bejne me:
  - (i) dhenien e aksioneve ose obligacioneve , te paraqitura si te paguara plotesisht, Anetareve respektivisht, mbi te cilat ata mund te kene te drejte ne kapitalizim, ose

- (ii) pagesen nga Shoqeria ne emer te Anetareve (duke aplikuar proporcionet e tyre respective te rezervave te vendosura per t'u kapitalizuar) te shumave ose pjese te shumave qe kane mbetur pa u paguar per aksionet e tyre ekzistuese; dhe
- (e) kryejne pergjithesisht te gjitha veprimet dhe gjerat e kerkuara per t'i dhene efekt rezolutes.

### **LLOGARIA E PRIMIT TE AKSIONEVE**

- 124. Drejtoret, ne perputhje me Nenin 34 te Ligjit te Shoqerive do te ngrene nje llogari te primit te aksioneve dhe do te fusin ne kete llogari here pas here nje shume te barabarte me shumen ose vleren e primit te paguar ne emetimin e aksionit.
- 125. Me kompensimin ose blerjen e nje aksioni, cdo llogarie te primit te aksioneve do t'i debitohet diferenca midis vleres nominale te ketij aksioni dhe cmimit te kompensimit ose blerjes, gjithmone me kusht qe, nen autoritetin e Drejtoreve, kjo shume mund te paguhet nga fitimet e Shoqerise ose, nese Neni 37 i Ligjit te Shoqerive e lejon, nga kapitali.

### **NJOFTIMET**

- 126. Cdo njoftim apo dokument mund te jepet nga Shoqeria apo nga nje person qe ka te drejten e njoftimit cdo Anetari si personalisht me fax ose me poste te parapaguar apo nepermjet nje sherbimi postar korrier te njohur, tarifa te parapaguara, te adresuara Anetarit ne adresen e tij sic rezulton ne Regjistrin e Anetareve. Ne rast te aksionereve te perbashket emri i te cileve eshte ne krye te Regjistrit te Anetareve ne lidhje me aksionet e perbashketa, cdo njoftim i tille do jete i mjaftueshem per te gjithe aksioneret e perbashket.
- 127. Cdo Anetar i pranishem, si personalisht dhe me prokure, ne cdo mbledhje te Shoqerise do quhet, per te gjitha qellimet, se ka marre njoftimin e duhur per mbledhjen dhe se, kur kerkohet, per qellimet per te cilat eshte thirrur mbledhja.
- 128. Cdo njoftim apo dokument tjeter, nese eshte dhene me (a) poste, do quhet si te jete dhene 5 dite pasi letra e cila permban te njejten gje te jete postuar , apo (b) fax do quhet si te jete dhene ne baze te riprodhimit nga transmetimi i makines fax te nje raporti qe konfirmon transmetim te plote te faksit ne numrin e faksit te marresit apo (c) sherbim postar i njohur, do quhet se eshte dhene 48 ore pasi letra e cila permban te njejten gje te jete dorezuar nga sherbimi postar. Per te provuar sherbimin postar apo me sherbimin me korrier mjafton te provohet se letra qe permban njoftimin apo dokumentet eshte derguar ne adrese te sakte dhe e postuar rregullisht apo e dorezuar nga sherbimi postar korrier.
- 129. Cdo njoftim apo dokument i dorezuar apo derguar me poste apo lene ne adresen e regjistruar te cdo Anetari ne perputhje me afatet e ketij Akt Themelimi do,

pavaresisht se ky Anetar do kete vdekur apo falimentuar, dhe nese Shoqeria ka njoftim per vdekjen apo falimentimin e tij, quhet i dhene ne lidhje me cdo aksion te regjistruar ne emer te ketij Anetari si aksioner i vetem apo perbashket, vetem ne rast se emri i tij ne kohen kur eshte ofruar sherbimi i njoftimit apo dokumenti, te jete hequr nga Regjistri i Anetareve si zoterues i aksioneve, dhe ky sherbim do, per te gjitha qellimet, quhet sherbim i mjaftueshem i ketij njoftimi apo dokumenti per te gjitha personat e interesuar (si te bashkuar apo si deklarues nepermjet apo per te) per aksionin.

130. Njoftimi per cdo mbledhje te pergjithshme te Shoqerise do t'i jepet:

- (a) te gjitha Anetareve posedues te aksioneve me te drejten per marrje njoftimi dhe personave qe i kane dhene Shoqerise nje adrese per t'i njoftuar ato; dhe
- (b) cdo personi qe ka te drejte aksioni si pasoje e vdekjes apo falimentimit te nje Anetari i cili per shkak te kesaj ka te drejte per te marre njoftim per mbledhjen.

Asnje person tjetër nuk ka te drejte te njoftohet per mbledhjet e pergjithshme.

#### **DEMSHPERBLIMI**

131. Cdo Drejtor (perfshire per qellimet e ketij Akt Themelimi cdo Drejtor i ndryshem i caktuar sipas dispozitave te ketyre Neneve) Sekretar, Sekretar Asistent, apo punojes tjetër tani dhe here pas here te Shoqerise (pa perfshire auditorët e Shoqerise) dhe personeli perfaqesuesit e te cilit do demshperblehen dhe te sigurohen te pacenuar nga asetët dhe fondet e Shoqerise ndaj te gjitha veprimeve, procedurave, kostove, tarifave, shpenzimeve, humbjeve, demtimeve apo pergjegjesive qe kane pesuar apo mbeshtetur nga ai ne lidhje me drejtimin e biznesit dhe puneve te Shoqerise apo per zbatimin e detyrave te tij, kompetencave, autoritetit apo diskrecionit te tij duke perfshire pa paragjikuat sa me lart, cdo kosto, shpenzim, humbje apo pergjegjesi te tij ne mbrojtjen (nese e sukseshme apo jo) e cdo procedure civile ne lidhje me Shoqerine apo punet e saj ne cdo gjykate si ne Ishujt Cayman dhe ne cdo vend tjetër.

132. Asnje Drejtor i tille, Drejtor alternativ, Sekretar, Sekretar Asistent apo punojes tjetër i Shoqerise (pa perfshire auditorët e Shoqerise) do jete pergjegjes (a) per aktet, deftese pagesat, neglizhimet, mospermbushjet e detyrimeve apo heqjen e cdo Drejtorit te tille apo punojesi apo agjenti te Shoqerise apo (b) per cdo humbje ne llogari te defektit te titullit te pronesisë te Shoqerise apo (c) per llogari te pamjaftueshmerise te cdo sigurie dhe mbi bazen e se ciles parate e Shoqerise do investohen apo (d) per cdo humbje pesuar me ndonje banke, agjent apo person tjetër te ngjashem apo (e) per cdo humbje te ndodhur nga neglizhenca, mospermbushja e detyrimit, shkelje e detyres, shkelja e besimit, gabim ne gjykim apo nga pakujdesia per te apo (f) per cdo humbje, demtim apo fatkeqesi te cdo

natyre qe mund te ndodhe apo te linde nga zbatimi apo lirimi i detyres, kompetencave, autoritetit, apo diskrecionit te detyres se tij apo ne lidhje me te, vetem ne rast se kjo ndodh per shkak te pandershmerise se tij.

### **MOSNJOHJA E DETYRES**

133. Asnje personi nuk do t'i njihet nga Shoqeria si mbajtes i aksionit me mirebesim dhe Shoqeria nuk do, vetem ne rast se kerkohet nga ligji, kufizohet nga apo te detyrohet ne asnje menyre per te njohur (madje dhe kur ka njoftim per kete) cdo interes te ardhshem, te arsyeshem e te mundshem ne aksionet e tij apo te drejta te tjera ne lidhje me te, pervec nje te drejte absolute per te gjitha sa me lart qe ka cdo Anetar i regjistruar ne Regjistrin e Anetareve.

### **SHPERBERJA**

134. Nese Shoqeria do shperbehet likuidatori mund, me sanksion te nje Vendimi Te Zakonshme te Shoqerise, ndaje midis Anetareve ne natyre apo ne leke te gjitha apo pjese te aseteteve te Shoqerise (si te jene prone e se njejtës natyre apo jo) dhe mund, per kte qellim te vendose kete vlere ne menyren qe ai e quan te drejte mbi bazen e cdo prone te ndashme si lartpermendur dhe mund te percaktoje se si kjo ndarje do kryhet si midis Anetareve apo klasave te ndryshme te aksioneve. Likuidatori mund, me kete sanksion, te konsideroje te pershtatshme, por ne menyre qe asnje Anetar te jete i detyruar te pranoje aksione apo garanci te tjera mbi te cilat ka pergjegjesi.

### **NDRYSHIM I AKTIT TE THEMELIMIT**

135. Shoqeria sipas Ligjit per Shoqerite dhe te drejtave bashkangjitur klasave te ndryshme te aksioneve, mund ne cdo kohe dhe here pas here me Vendim Te Vecante te ndryshoje dhe te ndreqe keto Nene ne teresi apo pjeserisht.

### **REGJISTRIM ME VAZHDIMESI**

136. Shoqeria mund te vendose me Vendim Special qe te regjistrohet me vazhdimesi ne nje juridiksion jashte ishujve Cayman apo ne nje juridiksion te tille i cili eshte i themeluar, regjistruar dhe ekziston. Ne mbeshtetje te vendimit te marre sipas ketij Neni, Drejtoret mund te kerkojne nga Regjistruesi i Shoqerive c`regjistrimin e Shoqerise ne Ishujt Cayman apo juridiksioni tjetër te tille ne te cilen eshte e themeluar, regjistruar dhe ekziston dhe mund te ndermarre hapa te metejshe sic mund ta konsiderojne te pershtatshme per te bere efektive transferimin me vazhdimesi te Shoqerise.

**EMRI, ADRESA DHE PERSHKRIMI  
I NENSHKRUESIT**

**NUMRI I AKSIONEVE TE  
MARRA NGA NENSHKRUESI**

---

**Philip Paschalides**  
PO Box 265GT  
Grand Cayman

NJE AKSION

(Sgd.) **Philip Paschalides**

---

**Philip Paschalides**  
Attorney-at-Law

15 Shkurt 2004

(Sgd.) **Sarah Sullivan**

---

Deshmitare e nenshkrimit te mesiperm: **Sarah Sullivan**

Adresa: PO Box 265GT, Grand Cayman

Profesioni: Sekretare

Une, D. EVADNE EBANKS, Asistent ne Regjistrin e Shoqerive, ne dhe per Ishujt Cayman, **VERTETOJ KETU** se kjo eshte nje kopje e vertete e Aktit te Themelimit te **SAXON INTERNATIONAL ENERGY LTD.**

Data: 15 Prill 2004.

(Vula, firma)

*Përkthues*  
*Sonide DHERI*  
